



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Komuna Hani i Elezit
Municipality of Hani i Elezit

02/ 6762 /2026
24.07.2026

Duke u bazuar në nenin 78 paragrafi 2, nenin 80, nenin 81 dhe nenin 82 të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenin 6 dhe nenin 7 të Rregullores (QRK) nr. 30/2024 për Procedurën e Pranimi të Nëpunësve të Shërbimit Publik në Sektorin e Shëndetësisë, Komuna Hani i Elezit shpall:

KONKURS PËR PRANIM

(Aplikimi është i hapur për gjithë kandidatët e interesuar)

Institucioni/ Drejtoria: Komuna Hani i Elezit/Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Titulli i pozitës së punës: Fizioterapeut/e

Numri i kërkuar: (1) një

Vendi i punës: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare “ Dr.Menduh Kaloshi”

Lloji i pozitës: Nëpunës i Shërbimit Publik

Koeficienti/paga: H 17- 6.4

Kohëzgjatja e Kontratës: Periudhë e pacaktuar (Periudha provuese 6 muaj)

Orët e punës: 40

Detyrat dhe përgjegjësitë

- 1.Ofron shërbime të vlerësimit për zhvillimin fizik dhe motorik të fëmijëve 0-6 vjeç, në bashkëpunim me profesionistët e tjerë të ekipit të Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme, përmes udhëzuesit për monitorimin e zhvillimit të fëmijës dhe instrumenteve të tjera të aprovuara nga Ministria e Shëndetësisë;
- 2.Kontribon në zhvillimin e Planit Individual të Shërbimeve për Familjen (PIShF) për fëmijët të cilët kualifikohen për shërbime të NFH-së, në bashkëpunim me profesionistët e tjerë të ekipit të NFH-së;
- 3.Ofron shërbime të Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme për fëmijët 0-6 vjeç në mjediset natyrore të fëmijës, të përqendruara tek familja, të cilat mbështesin, zhvillojnë dhe përmirësojnë aftësitë që lidhen me motorikën, koordinimin, balancin, dhe vetëndihmën;
- 4.Monitoron, dokumenton dhe raporton mbi progresin e fëmijëve që përfitojnë nga shërbimet e NFH-së si dhe kontribuon në rishikimin e rregullt të PIShF;
- 5.Ofron këshilla dhe konsulta të individualizuara prindërve lidhur me mbështetjen e zhvillimit të fëmijëve 0-6 vjeç;
- 6.Organizon sesione promovuese me prindër, ofrues të shërbimeve, si dhe përfaqësues të institucioneve për promovimin e programit të Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme;
- 7.Merr pjesë në trajnime dhe aktivitete të zhvillimit profesional në fushën e Ndërhyrjes në Fëmijërinë e Hershme.
- 8.Kryen edhe detyra të tjera profesionale në përputhje me kompetencat e pozitës dhe sipas kërkesës së eporit.

Kriteret e përgjithshme për pranim:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotëroj njërën nga gjuhët zyrtare në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe /apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës;
- Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në Ligjin për Zyrtarët Publik.

Kërkesat e përgjithshme formale dhe të nevojshme:

Arsimimi i kërkuar: Diplomë universitare në drejtimin Fizioterapi apo Ergoterapi në mungesë të fizioterapeutit.

Licencë pune valide nga Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës

Përvojë pune: nuk kërkohet

Dokumentet që duhet paraqitur për aplikim:

1. Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës.
2. Kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës. Nëse diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të kontratës.
3. Kopjet e dëshmisë së punësimit (vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë. Dëshmisë e punësimit jashtë institucioneve publike duhet të mbështet së paku njëra nga dëshmitë si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personal. Përvoja e punës, e cila deklarohet sipas kushteve të konkursit , e fituar në një shtet tjetër, dëshmohet përmes dëshmisë së përkthyer mbi përvojën e punës së lëshuar nga organi kompetent i atij shteti, apo përmes dëshmisë së përkthyer dhe noterizuar të përvojës të lëshuar nga punëdhënësi përkatës.
4. Kopjen e licencës së punës të lëshuar nga organi kompetent (me afat).
5. Dëshmitë e trajnimeve profesionale të ndjekura apo trajnimeve që aplikuesi i ka realizuar në cilësinë e trajnuesit.
6. Dëshmi që nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (kandidatët që janë të punësuar apo kanë qenë të punësuar në institucione publike).
7. Kopjet e dokumenteve tjera që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.

Dokumentet që dorëzohen në fazën e verifikimit para emërimit:

1. Dëshmi përkatëse se kandidati ka zotësi të plotë për të vepruar.
2. Certifikatën mbi denimet penale origjinale e lëshuar nga gjykata përmes së cilës dëshmohet se nuk është i/e dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje, jo më të vjetër se 6 muaj nga data e lëshimit.
3. Diploma e kualifikimit arsimor e noterizuar.
4. Dëshmi se kandidati është i aftë në pikëpamje shëndetësore.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve:

Sipas Rregullores(QRK) nr.30/2024 për Procedurën e Pranimit të Nëpunësve të Shërbimit Publik në Sektorin e Shëndetësisë.

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data 25.07.2026 deri më 23.08.2026 nga ora 08:00-16:00.

Të gjithë kandidatët e interesuar aplikacionin e punësimit mund t'i marrin në formë fizike pranë Qendrës për Shërbim me Qytetarë në Komunë në Han të Elezit dhe të plotësuar e dorëzojnë në të njëjtin vend, apo ti shkarkojnë në portalin shtetëror <https://konkursi.rks-gov.net>

Dokumentet duhet të jenë në kopje sepse ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

Nëse kandidatët aplikojnë në dy e më tepër vende të punës, kandidatët duhet të dorëzojnë aplikacione të veçanta për secilin vend të punës.

Dokumentacioni i kandidatëve të cilët nuk i plotësojnë kriteret e konkursit nuk do të shqyrtohen ndërsa në faza tjera do të ftohen vetëm kandidatët që i plotësojnë kriteret e që futen në listë të ngushtë.

Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional, siç specifikohet në LZP.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta nuk pranohen.

Kandidati përmes aplikacionit deklaron dhe mban përgjegjësi për vërtetësinë e të gjitha dokumenteve të dorëzuara siç kërkohen nga shpallja e procedurës së rekrutimit. Deklarimi i rrejshëm paraqet shkas për përjashtim nga procedura e rekrutimit.

Konkursi dhe rezultatet shpallen në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/>, web faqen e komunës <https://haniielezit.rks-gov.net> dhe në tabelën e shpalljes.

